

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Valon Totaj – kryetar i kolegjit, Nora Bllaca Dula dhe Albert Zogaj – anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses S.H. nga fshati ..., Komuna Lipjan, të cilën me autorizim e përfaqëson av.E.A. nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Lipjanit – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën e përfaqëson av. Publike Komunale F.M., për shkak të kompensimit të të ardhurave personale, vlera e kontestit 9,558.87 €, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Lipjan C.nr.63/2014, të datës 13.05.2015, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 31.08.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurës Komuna e Lipjanit – Drejtoria Komunale e Arsimit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Lipjan C.nr.63/2014, i datës 13.05.2015, **VËRTETOHET**, përveq për pjesën e llogaritjes së kamatës, për të cilën pjesë aktgjykimi në fjalë **NDRYSHOHET** dhe gjykohet ashtu që kamata do të llogaritet nga dita e marrjes së aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë 13.05.2015, e deri në pagesën definitive.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.63/2014, të datës 13.05.2015, e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses S.H. nga fshati ... si e bazuar dhe e ka detyruar të paditurën Komuna e Lipjanit që paditëses t’ia paguaj të ardhurat personale dhe atë për muajt Tetor, Nëntor dhe Dhjetor të vitit 2011, si dhe për tërë vitin 2012 dhe vitin 2013, shumën e përgjithshme prej 9.558,87 €, me kamatë ligjore sa paguajnë bankat për mjetet e deponuara me shumë sa një vit pa destinim, si dhe t’ia kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 474.40 € deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e dorëzimit të aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura në afat ligjor ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljes së dispozitave materiale, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe shkeljeve esenciale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovojë ankesën e të paditurës Komuna e Lipjanit në tërësi si të bazuar dhe ta prishë aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega Lipjan C.nr.63/2014 me datë 13.05.2015 dhe lënda të kthehet në rigjykim dhe vendosje.

Përgjigje në ankesë nuk është parashtruar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e **pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja S.H. me datë 04.02.2014, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi për kompensimin e të ardhurave personale kundër të paditurës Komuna e Lipjanit – Drejtoria Komunale e Arsimit, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që në emër të kompensimit të të ardhurave personale për muajin Tetor, Nëntor dhe Dhjetor të vitit 2011 t'ia paguaj shumën prej 300 €, kurse për tërë vitin 2012 dhe 2013 t'ia paguaj shumën e cila do të precizohet në pajtim me ekspertizën financiare, me kamatë ligjore e cila vlen për mjetet të deponuara në bankë në afat më tepër së një vit pa destinim të caktuar filluar nga arritja e çdo kërkesë për pagesë e deri me datë 20.12.2012 ndërsa me kamatë prej 8 % duke filluar prej datës 20.12.2012 e deri te pagesa e plotë.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të prezantuara nga palët ndërgjyqëse, në seancë të shqyrtimit kryesor ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.63/2014, të datës 13.05.2015, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar. Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar gjykata ka theksuar senë cilësi të provave materiale ka administruar kontratat e punës të lidhur në mes të paditëses dhe të paditurës të datës 02.09.2013, 01.10.2012 dhe 01.09.2011, dhe vërtetimin nr.2/3005 të datës 05.12.2013, të lëshuar nga Shkolla e Mesme Profesionale “Adem Gllavica” në Lipjan, , me të cilën vërtetohet se paditësja ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura si mësimdhënëse e lëndës së Ndërtimtarisë nga data 01.03.2011 deri me datë 31.08.2012, kurse nga data 01.10.2012 ka vazhduar të punojë si mësimdhënëse e lëndës së Matematikës në kohëzgjatje prej 01.10.2012 e deri me datë 31.08.2014 dhe detyrat e punës i ka kryer sipas kontratës së punës me orë të plota mësimi me të ardhura mujore në shumë prej 353.81 €. Më tutje gjykata ka theksuar se gjatë kësaj periudhe të kryerjes së punës paditësja nuk ka realizuar të ardhura mujore nga e paditura dhe ka arsyetuar se e paditura me deklaratë e saj nuk e ka kontestuar kërkesëpadinë e paditëses.

Vendimin mbi shpenzimet e ka nxjerrë në mbështetje të nenit 452 dhe 453 të LPK-së.

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të pretenduara dhe as në shkeljet nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe rrjedhimisht nuk ka aplikim të gabuar të drejtës materiale për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të autorizuarit të të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin.

Gjykata i ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe disa fakte vendimtare nuk kanë qenë kontestuese. Nuk ka qenë kontestuese në mes palëve se paditësja ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura si mësimdhënëse e lëndës së Ndërtimtarisë nga data 01.03.2011 deri me datë 31.08.2012, kurse nga data 01.10.2012 ka vazhduar të punojë si mësimdhënëse e lëndës së Matematikës në kohëzgjatje prej 01.10.2012 e deri me datë 31.08.2014.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale për arsyeje se me nenin 50 parg. 1 të Ligjit të Punës, përcaktohet se *“I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit”*.

Gjykata e Apelit vlerëson se në rastin konkret drejtë është zbatuar e drejta materiale, e për të cilat shkaqe kjo gjykatë kujdeset zyrtarisht, përveç për pjesën e llogaritjes së kohës së kamatës së gjykuar, për të cilën Gjykata e Apelit gjen se është bërë zbatimi i gabuar i të drejtës materiale pasi që për të njëjtën nuk është vendosur fare nga gjykata e shkallës së parë, andaj në këtë pjesë gjykata e ka ndryshuar aktgjykimin e atakuar vetëm sa i përket kohës së fillimit të llogaritjes së saj, duke e gjykuar se e njëjta do të llogaritet nga dita e marrjes së aktgjyimit të shkallës së parë 13.05.2015, e deri në pagesën definitive, në kuptim të nenit 277 të LMD.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 195.1 pika d) dhe e), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.3128/15, me datën 31.08.2018

Kryetari i Kolegjit - Gjyqtari,
Valon Totaj